

Manual mbi procedurat e aplikimit per thirrjet e programit



Tabela e Përmbajtjes

1. PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT ERASMUS+

- Çfarë është Erasmus+: objektivat dhe përfitimet e programit Erasmus+
- Roli i Zyrës Erasmus+ në Kosovë
- Cilat janë thirrjet që Kosova ka të drejtë aplikimi/pjesëmarrje?

2. FUSHAT E APLIKIMIT PËR KOSOVË SIPAS LLOJIT TË INSTITUCIONEVE

● Mundësitë e Programit Erasmus+ për Institucionet e Arsimit të Lartë

- Regjistrimi dhe mënyra e aplikimit
 - ✓ Hapat e aplikimit për studentët dhe stafin akademik të arsimit të lartë.
 - ✓ Afatet dhe dokumentet e kërkuara për aplikim.

● Mundësitë e Programit Erasmus+ për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

- Regjistrimi dhe mënyra e aplikimit
 - ✓ Procedurat e aplikimit për institucionet që ofrojnë trajnim dhe aftësim profesional.
 - ✓ Afatet dhe dokumentet e kërkuara për aplikim.

● Mundësitë e Programit Erasmus+ për Rini

- Regjistrimi dhe mënyra e aplikimit
 - ✓ Hapat dhe kërkesat për aplikimin për organizata rinore dhe individë të rinj.
 - ✓ Afatet dhe dokumentet e kërkuara për aplikim.

● Mundësitë e Programit Erasmus+ për Sport

- Regjistrimi dhe mënyra e aplikimit
 - ✓ Procedurat për aplikimin për individë dhe organizata që punojnë në fushën e sportit.
 - ✓ Afatet dhe dokumentet e kërkuara për aplikim.

3. KONTAKTI DHE INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- Si mund të aplikoni për Erasmus+?
 - Hapat për aplikim dhe dokumentet që kërkohen për çdo thirrje.
 - Lidhjet me platformën e aplikimeve online (nëse është e disponueshme).
- Përgjigje për pyetje të shpeshta
- Kontakte të Zyrës Erasmus+ në Kosovë
- Burimet dhe platforma online

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT ERASMUS+

- **Çfarë është Erasmus+**

Erasmus+ është një program i financuar nga Bashkimi Evropian që ofron mundësi për mobilitet dhe bashkëpunim ndërkombëtar për individë dhe institucione në fushat e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit.

Programi synon përmirësimin e aftësive, zhvillimin e mundësive të punësimit, dhe forcimin e lidhjeve ndërkombëtare për individë dhe organizata.

Përmes Erasmus+, institucionet dhe organizatat nga Kosova mund të bashkëpunojnë me partnerë evropianë, të shkëmbejnë përvoja dhe të përfitojnë nga mbështetja për projekte zhvillimore dhe edukative. Ndërkohë, individët që marrin pjesë në mobilitete fitojnë përvoja të vlefshme që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e tyre personal dhe profesional.

Programi zbatohet nga Komisioni Evropian përmes Agjencisë Ekzekutive për Arsimin dhe Kulturën (EACEA), në bashkëpunim me Agjencitë Kombëtare në vendet e programit dhe Zyrat Kombëtare Erasmus+ në vendet partnere, përfshirë Kosovën.

- **Roli i Zyrës Erasmus+ në Kosovë**

Në Kosovë, zbatimi i programit mbështetet nga Zyra Kombëtare Erasmus+, e cila ofron ndihmë për institucionet, organizatat dhe individët në shfrytëzimin e mundësive që programi ofron.

Zyra Erasmus+ në Kosovë (KEO/ZEK) është përgjegjëse për menaxhimin dhe promovimin e mundësive që ofron Programi Erasmus+ për Kosovën. Ajo ofron mbështetje dhe udhëzime për individët dhe institucionet që duan të aplikojnë për mundësi në fushat e arsimit të lartë, arsimit dhe trajnimit profesional, rinisë dhe sportit. Zyra gjithashtu ofron informacion të detajuar, asistencë teknike për zhvillimin e projekteve, dhe ndihmon në gjetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Përmes veprimtarive të saj, Zyra Erasmus+ kontribuon në forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe krijimin e mundësive për zhvillim dhe shkëmbim të përvojave ndërkombëtare, duke ofruar mundësi për të rinjtë, studentët, stafin, dhe profesionistët e arsimit në Kosovë.

- **Cilat janë thirrjet që Kosova ka të drejtë aplikimi/pjesëmarrje?**

Kosova mund të aplikojë në thirrje për mobilitet për studentë, stafe, organizata rinore, dhe institucione edukimi, si dhe mund të marrë pjesë në projekte që mbështesin zhvillimin e kapaciteteve në fushën e Arsimit të Lartë, Arsimit profesional, Rinisë dhe Sportit. Për t'u siguruar nëse institucioni juaj ka të drejtë aplikimi, referojuni tabelës së mëposhtme dhe shqyrtoni Udhëzuesin e përgjithshëm të Programit.

Veprimi i Programit Erasmus+ (Key Action)	Pjesëmarrja e Kosovës
Key action 1 – Learning Mobility of individuals	
Mobility project for higher education students and staff (“Erasmus”)	*
Mobility project for higher education with partner countries (“ICM”)	*
Mobility of young people ‘Youth exchanges’	*
Mobility projects for Youth workers	*
Youth participation activities	*
Virtual exchanges in higher education and youth	*
Key action 2 - Cooperation for innovation and the exchange of good practices	
Cooperation Partnerships	*
Centres of Vocational Excellence	*
Erasmus Mundus Actions	**
Alliances for Innovation	*
Capacity-building in the field of higher education	**
Capacity-building in the field of VET	*
Capacity-building in the field of Youth	**
Capacity-building in the field of Sports	**
Key action 3 - Support for policy reform	
Jean Monnet actions in the field of higher education	**
Jean Monnet Policy Debate	**

* Mund të përfshihet vetëm në rolin e institucionit partner

** Ka të drejtë aplikimi në rolin e institucionit aplikant/bartës dhe si partner

 Pjesëmarrja e Kosovës është e mundur vetëm nëse paraqet vlerët të shtuar për projektin

MUNDËSITË E
Erasmus+
PËR
INSTITUCIONET NË
KOSOVË,
SIPAS FUSHËS SË APLIKIMIT



**MUNDËSITË
E
PROGRAMIT
Erasmus+**

**PËR
INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË
LARTË**

1. KA1 MOBILITETE/SHKËMBIME AFATSHKURTËRA PËR STAF DHE STUDENTË (ICM)

Çka është ICM?

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë mund të aplikojnë për mobilitetin e studentëve dhe stafit, përfshirë mundësi për studime, trajnime dhe punë praktike jashtë vendit. Kjo ndihmon zhvillimin e aftësive dhe shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare. Periudha e lëvizjes mund të jetë nga 2 muaj (ose një semestër akademik) deri në 12 muaj për studentët, kurse për stafin akademik dhe administrativ 5 ditë deri në 2 muaj.

Si të aplikoni?

Aplikimi është **institucional**, jo individual. Institucioni i arsimit të Lartë në Kosovë (qoft publik apo privat) shpreh interesim për pjesëmarrje në projektet ICM dhe negocion me universitetin partner mbi detajet e shkëmbimit (numri i studentëve dhe stafit, periudha e studimit, niveli gjuhësor etj.). Pas arritjes së marrëveshjes, nënshkruhet një marrëveshje ndër-institucionale. Kosova ka të drejtë aplikimi vetëm si vend partner, që do të thotë se vendi bartës/koordinues është ai nga vendet e Programit (vendet e BE-së ose vendet e treta që asociojnë me Programin (Turqia, Islanda, Liechtensteini, Norvegjia, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), dhe ku më tutje institucioni bartës aplikon pranë Agjencisë së tyre Nacionale Erasmus+.

Mbështetja financiare:

Shuma që mund të merrni për udhëtimin dhe shpenzimet e jetesës mund të ndryshojë në varësi të disa faktorëve, përfshirë shtetin ku student/stafi përfundon mobilitetin dhe vendin e origjinës, andaj për të marrë informacione më të sakta dhe të përditësuara, është e nevojshme të kontaktoni institucionin tuaj, pasi shumat mund të ndryshojnë çdo vit dhe për çdo shtet.

2. SHKËMBIME VIRTUALE PËRMES PROGRAMIT ERASMUS+

Shkëmbimet virtuale në kuadër të Erasmus+ janë aktivitete që lejojnë nxënësit, studentët dhe edukatorët të bashkëpunojnë dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin përmes platformave digjitale, pa nevojën për udhëtime fizike. Këto shkëmbime promovojnë ndërgjegjësimin ndërkulturor, zhvillimin e aftësive dixhitale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në arsim dhe trajnime. Ato janë një mënyrë fleksibile dhe e përballueshme për të përfituar nga përvojat Erasmus+, duke i dhënë mundësi pjesëmarrësve të krijojnë lidhje dhe të mësojnë nga kultura dhe praktikatat e ndryshme, edhe kur udhëtimi fizik nuk është i mundur.

Kush ka të drejtë aplikimi për shkëmbimet virtuale në Erasmus+?

- **Nxënës** dhe **studentë** në shkolla, universitete, ose institucione arsimore të akredituara.
- **Edukatorë, mësues, trajnerë** dhe stafi arsimor.
- **Organizata arsimore**, qendra trajnime, shoqata rinore, dhe organizata joqeveritare që punojnë në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë.
- Grupet apo organizatat nga vendet pjesëmarrëse në programin Erasmus+.

Si të aplikoni?

- Organizata (shkolla, universiteti, ose organizata partnere) paraqet një **projekt** për shkëmbime virtuale në kuadër të thirrjes së Erasmus+ për aplikime.
- Aplikimi bëhet nëpërmjet platformës online të **Komisionit Evropian** ose agjencive kombëtare Erasmus+.
- Në projekt përshkruhen aktivitetet virtuale, qëllimet, mënyra e bashkëpunimit, dhe rezultatet e pritshme.
- Pasi projekti miratohet, përfshihen pjesëmarrësit dhe zhvillohen aktivitetet virtuale sipas planit.

Aplikantët (përfutuesit dhe entitetet e lidhura, nëse është rasti) duhet të jenë të themeluara në një nga vendet e pranueshme, që do të thotë:

- Një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (BE)
- Një shtet i tretë i lidhur me Programin Erasmus+
- Një shtet i tretë jo i lidhur me Programin, por nga një rajon i pranueshëm ku bënë pjesë Kosova.

3. KA2 PROJEKTE PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE NË ARSIMIN E LARTË

Institucionet nga Kosova mund të aplikojnë për projekte për ngritjen e kapaciteteve në Arsimin e Lartë (CBHE) që janë të financuara nga Bashkimi Evropian dhe që ndihmojnë në përmirësimin e arsimit të lartë nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar. Ato mbështesin modernizimin e kurseve, teknologjive dhe mundësive për mobilitetin e studentëve dhe stafit.

Të drejtë pjesëmarrje në këto projekte kanë:

- Institucionet e arsimit të lartë (publike dhe private) të cilat janë të akredituara në Kosovë;
- Organizatat ose institucionet aktive në tregun e punës ose në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë.

Shtyllat e projekteve:

Për të përballuar sfidat e ndryshme në shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin, në këtë rast Kosova ka të drejtë aplikimi në tri shtylla apo fusha specifike:

- Shtylla 1: Nxitja e qasjes për bashkëpunime në arsimin e lartë;
- Shtylla 2: Partneritetet për bashkëpunim në arsimin e lartë
- Shtylla 3: Projekte për reforma strukturore në arsim

Shtylla 1. NXITJA E QASJES PËR BASHKËPUNIME NË ARSIMIN E LARTË

Kjo shtyllë është krijuar për të tërhequr IAL-të me përvojë të pakët dhe akterët e rinjë në veprimtarinë e projekteve për ngritje të kapaciteteve (CBHE), për të lehtësuar qasjen për organizatat e reja.

Përbërja e parterëve të projektit:

Aplikimet nuk mund të bëhen nga një institucion i vetëm nga Kosova, por duke përbër partneritetin nga minimum 6 institucione, si në vijim:

- 🏢 Të paktën 2 shtete anëtare të BE-së ose shtete të treta të asociuara me Programin;
 - Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 1 institucion të arsimit të lartë.
- 🏢 Të paktën 2 shtete të treta që nuk janë të asociuara me Programin (ku bënë pjesë Kosova);
 - Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 2 institucione të arsimit të lartë. Shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin mund të jenë nga i njëjti rajon (projekte rajonale) ose nga rajone të ndryshme (projekte ndër-rajonale).
- 🏢 Numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta të asociuara me Programin.

*Organizatave ose institucionet aktive në tregun e punës ose në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë, nuk mund të përfshihen në numrin minimal të partnerëve të kërkuar dhe poashtu nuk mund të jenë bartëse të projekteve, por mund të shtohen në konsorciumin e krijuar nga universitetet, nëse paraqesin një vlerë të shtuar në arritjen e objektivave të projektit.

Kosova ka të drejtë aplikimi si bartës (aplikant) dhe si partner.

Kohëzgjatja e projekteve: 24 ose 36 muaj

Shuma e financimit: 200.000 deri në 400.000 Euro. Projektet CBHE janë financim "lump sum", që do të thotë se financimi jepet si një shumë fikse për të mbuluar të gjitha kostot e projektit.

Shtylla 2. PARTNERITETET PËR BASHKËPUNIM NË ARSIMIN E LARTË

Projektet nën këtë shtyllë kanë për qëllim të sjellin qasje dhe iniciativa të reja në arsimin e lartë, të bazuara në mësimdhënien nga bashkëpunimi dhe shpërndarjen e eksperiencave dhe praktikave të mira, që do të ndikojnë jo vetëm në institucionet, por edhe në shoqërinë në përgjithësi.

Përbërja e parterëve të projektit:

Aplikimet nuk mund të bëhen nga një institucion i vetëm nga Kosova, por duke përbër partneritetin nga minimum 6 institucione, si në vijim:

- Të paktën 2 shtete anëtare të BE-së ose shtete të treta të asociuara me Programin;
 - Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 1 institucion të arsimit të lartë.
- Të paktën 2 shtete të treta që nuk janë të asociuara me Programin (ku bënë pjesë Kosova);
 - Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 2 institucione të arsimit të lartë. Shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin mund të jenë nga i njëjti rajon (projekte rajonale) ose nga rajone të ndryshme (projekte ndër-rajonale).
- Numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta të asociuara me Programin.

*Organizatave ose institucionet aktive në tregun e punës ose në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë, nuk mund të përfshihen në numrin minimal të partnerëve të kërkuar dhe poashtu nuk mund të jenë bartëse të projekteve, por mund të shtohen në konsorciumin e krijuar nga universitetet, nëse paraqesin një vlerë të shtuar në arritjen e objektivave të projektit.

Kosova ka të drejtë aplikimi si bartës (aplikant) dhe si partner.

Kohëzgjatja projekteve: 24 ose 36 muaj

Shuma e financimit: 400.000 deri në 800.000 Euro. Projektet CBHE janë financim "lump sum", që do të thotë se financimi jepet si një shumë fikse për të mbuluar të gjitha kostot e projektit.

Shtylla 3. PROJEKTE PËR REFORMA STRUKTURE NË ARSIM

Këto projekte kanë për qëllim zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të arsimit të lartë, që përmbushin nevojat e tyre socio-ekonomike dhe synimin për krijimin e një ekonomie të bazuar në njohuri.

Përbërja e parterëve të projektit:

- Të paktën 2 shtete anëtare të BE-së ose shtete të treta të asociuara me Programin;
 - Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 1 institucion të arsimit të lartë.
 - Të paktën 1 shtet i tretë i që nuk është i asociuar me Programin;
 - o Secili shtet pjesëmarrës duhet të përfshijë të paktën 2 institucione të arsimit të lartë; dhe
 - o Autoriteti kompetent kombëtar përgjegjës për arsimin e lartë në vend (psh. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë).
 - Numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta të asociuara me Programin.

Kosova ka të drejtë aplikimi si bartës (aplikant) dhe si partner.

*Organizatave ose institucionet aktive në tregun e punës ose në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë, nuk mund të përfshihen në numrin minimal të partnerëve të kërkuar dhe poashtu nuk mund të jenë bartëse të projekteve, por mund të shtohen në konsorciumin e krijuar nga universitetet, nëse paraqesin një vlerë të shtuar në arritjen e objektivave të projektit.

Kohëzgjatja projekteve: 36 ose 48 muaj

Shuma e financimit: 600.000 deri në 1.000.000 Euro. Projektet CBHE janë financim "lump sum", që do të thotë se financimi jepet si një shumë fikse për të mbuluar të gjitha kostot e projektit.

4. PROJEKTE PËR DIZAJNIMIN E PROGRAMEVE MASTER TË PËRBASHKËT

Janë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian që synojnë krijimin dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta master, ku universitetet nga shtete të ndryshme bashkëpunojnë për të ofruar programe akademike ndërkombëtare. Këto projekte ndihmojnë në modernizimin e kurseve, ofrojnë mundësi për studentët për të studiuar në më shumë se një vend, dhe përmirësojnë cilësinë e arsimit të lartë.

Përbërja e parterëve të projektit:

Për të qenë të pranueshëm për aplikim, aplikuesit (përfituesit dhe entitetet e ndërlidhura) duhet:

- të jenë **persona juridikë** (organe publike ose subjekte private);
- të jenë **Institucione të Arsimit të Lartë (IAL)** të themeluara në njërin nga vendet e pranueshme për programin, pra:
 - një **Shtet Anëtar i BE-së**,
 - një **vend i tretë i asociuar me Programin**, ose
 - një **vend i tretë i pranueshëm, jo i asociuar me Programin** (siç është rasti i Kosovës).

Kohëzgjatja projekteve: Kohëzgjatja standarde e projekteve është 74 muaj. Zgjatja e projektit është e mundur vetëm në rastet kur është e arsyetuar në mënyrë të plotë dhe miratohet përmes një amendamenti zyrtar.

5. PROJEKTET JEAN MONNET:

Projektet Jean Monnet janë iniciativa të financuara nga Bashkimi Evropian që mbështesin mësimin dhe hulumtimin në fushën e studimeve evropiane. Këto projekte janë krijuar për të promovuar njohuritë dhe diskutimet mbi çështjet e Bashkimit Evropian, si dhe për të forcuar lidhjet ndërkombëtare në arsimin dhe hulumtimin e BE-së. Projektet Jean Monnet përfshijnë kurse të specializuara, aktivitete trajnimi, hulumtime dhe krijimin e mundësive për studentët dhe profesionistët për të mësuar më shumë për historinë dhe zhvillimet e BE-së.

Veprimet Jean Monnet në Fushën e Arsimit të Lartë

Veprimet Jean Monnet mbështesin mësimdhënien dhe hulumtimin për çështjet që lidhen me Bashkimin Evropian – si historiku, funksionimi, politikat dhe vlerat e tij. Këto aktivitete synojnë të nxisin qytetarinë aktive evropiane dhe të promovojnë vlerat themelore si: dinjiteti njerëzor, demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut.

Në kontekstin e Kosovës, veprimet Jean Monnet ofrojnë mundësi për institucionet e arsimit të lartë që të zhvillojnë projekte të mësimdhënies dhe hulumtimit me fokus në temat e BE-së, duke kontribuar edhe në diplomacinë publike dhe rritjen e dukshmërisë së BE-së në rajon.

Format e Projekteve Jean Monnet

Projekti duhet të marrë njërën nga format e mëposhtme:

▣ **Modulet Jean Monnet**

Kurse të shkurtra (minimum 40 orë mësimore në vit) që trajtojnë tema të BE-së. Mund të jenë multidisiplinare ose të fokusuara në një fushë të caktuar.
Kohëzgjatja: 36 muaj (me mundësi zgjatjeje në raste të arsyetuara).
Granti maksimal: 35,000 EUR

▣ **Jean Monnet Chair**

Pozita mësimore për një profesor të rregullt në një institucion të arsimit të lartë, që zhvillon minimum 90 orë mësimore në vit për temat e BE-së.
Kohëzgjatja: 36 muaj (me mundësi zgjatjeje në raste të arsyetuara).
Granti maksimal: 60,000 EUR

▣ **Qendrat e Ekselencës Jean Monnet**

Qendra me ekspertizë të lartë në studimet për BE-në, që përfshijnë aktivitete ndërdisiplinare dhe bashkëpunim me shoqërinë civile. Një institucion mund të ketë vetëm një qendër të tillë aktive.
Kohëzgjatja: 36 muaj (me mundësi zgjatjeje në raste të arsyetuara).
Granti maksimal: 100,000 EUR

Kriteret për aplikim

Për të aplikuar, duhet të plotësohen këto kushte:

- Aplikanti duhet të jetë **institucion i arsimit të lartë (IAL)**.
- Mund të jetë i vendosur në një **shtet anëtar të BE-së, një vend i asociuar me Programin** ose **një vend i tretë jo i asociuar**, si Kosova.
- IAL-të në vendet e asociuara duhet të kenë **Certifikatën ECHE** (Erasmus Charter for Higher Education).

Aplikimet janë të mundshme vetëm nga aplikantë individualë (jo konsorciume).

Si të aplikoni: Aplikimi bëhet përmes platformës online ‘FTOP’ (Funding and Tenders opportunity Portal) dhe kërkohet dokumentacion specifik për secilën thirrje.

Afatet e aplikimit: Afatet ndryshojnë sipas thirrjes dhe institucioni duhet të respektojë datat për aplikim dhe dokumentet përkatëse.

Për më shumë informata: Konsultoni udhëzuesin e përgjithshëm të Programit Erasmus+



**MUNDËSITË
E
PROGRAMIT
Erasmus+**

**PËR
INSTITUCIONET E
ARSIMIT DHE
AFTËSIMIT
PROFESIONAL**

1.KA2 Projekte për ngritjen e kapaciteteve në fushën e Arsimit dhe aftësimin profesional (CBVET):

Institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë kanë mundësi të aplikojnë për projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit profesional dhe trajnimeve. Këto projekte ndihmojnë në modernizimin e institucioneve, zhvillimin e aftësive profesionale dhe krijimin e mundësive për shkëmbime ndërkombëtare për studentët dhe stafin. Qëllimi është të forcohen kapacitetet e këtyre institucioneve për t'u ofruar të rinjve dhe punëkërkuësve arsim dhe trajnim më cilësor.

Përbërja e parterëve të projektit: Aplikimi nuk mund të bëhet nga një institucion i vetëm nga Kosova. Partneriteti duhet të përbëhet nga të paktën 4 institucione nga 3 shtete të ndryshme, sipas këtyre kriterëve:

	Të paktën 4 organizata	Nga minimum 3 shtete të ndryshme
Mundësia 1	2 organizata (koordinator+ partner të plotë) + 2 organizata (partner të plotë)	2 Shtete anëtare të BE-së + 1 vend i tretë që nuk asocion me Programin
Mundësia 2	2 organizata (koordinator+ partner të plotë) + 2 organizata (partner të plotë)	2 Vende të treta që asocojnë me Programin + 1 vend i tretë që nuk asocion me Programin
Mundësia 3	2 organizata (koordinator+ partner të plotë) + 2 organizata (partner të plotë)	1 Shtet anëtar I BE-së + 1 Vend I tretë që asocion me Programin + 1 vend i tretë që nuk asocion me Programin
NUK ËSHTË E PRANUESHME	Numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta të asociuara me Programin NUK MUND TË JETË MË I MADH sesa numri i organizatave pjesëmarrëse nga shtetet e treta që nuk janë të asociuara me Programin. Shembull: 3 organizata nga 2 vende të BE-së + 2 organizata nga 1 vend i tretë që nuk është i asociuar me Programin (nuk pranohet).	

Organizatat pjesëmarrëse të pranueshme:

- Ofrues të arsimit dhe aftësimit profesional (VET)
- Organizata të tjera publike ose private që janë aktive në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional (VET) ose në tregun e punës:
 - o Ofrues të arsimit dhe aftësimit profesional (VET);
 - o Kompani, organizata përfaqësuese të industrisë ose sektorëve të caktuar;
 - o Autoritete kombëtare/rajonale për kualifikimet;
 - o Shërbime të punësimit;
 - o Institute kërkimore;
 - o Agjenci të inovacionit;
 - o Autoritete të zhvillimit rajonal, etj.

Në projektet për ngritjen e kapaciteteve në arsimin profesional (CBVET), Kosova ka të drejtë aplikimi **vetëm** si partner.

Informata rreth thirrjes – Udhëzuesi i përgjithshëm i Programit Erasmus+



Kohëzgjatja e projektit

1, 2 ose 3 vite



Buxheti

Granti i paraparë nga BE për një projekt varion nga **100.000 €** deri në **400.000€**
Granti mund të mbuloj shpenzimet deri në **80%** të shumës totale të projektit



Ku duhet të aplikoni

[Funding and Tenders opportunities portal](#)



Afatet e aplikimit

Afatet ndryshojnë sipas thirrjes dhe institucioni duhet të respektojë datat për aplikim dhe dokumentet përkatëse.

Projektet CBVET janë financim "lump sum", që do të thotë se financimi jepet si një shumë fikse për të mbuluar kostot e projektit.



**MUNDËSITË E
PROGRAMIT**



**PËR ORGANIZATAT
NË FUSHËN E
RINISË**

KA2 Projekte për ngritjen e kapaciteteve në fushën e Rinisë: Organizatat rinore që veprojnë në Kosovë kanë të drejtë që të përfitojnë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian që synojnë përmirësimin e mundësive për rininë, duke mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të organizatave rinore dhe krijimin e mundësive për aktivitete ndërkombëtare. Ato fokusohen në zhvillimin e aftësive të rinjve, mobilitetin dhe shkëmbimin kulturor.

Si të aplikoni: Aplikimi bëhet përmes platformës online ‘FTOP’ (Funding and Tenders opportunity Portal) dhe kërkohet dokumentacion specifik për secilën thirrje.

**Vini re që këto projekte kanë numër të caktuar(minimal) të partnerëve të përfshirë për çdo kategori të projekteve.*

Afatet e aplikimit: Afatet ndryshojnë sipas thirrjes dhe institucioni duhet të respektojë datat për aplikim dhe dokumentet përkatëse.

Për më shumë informata: Konsultoni udhëzuesin e përgjithshëm të Programit Erasmus+

*Përmes Programit Erasmus+ organizatat rinore kanë të drejtë që të aplikojnë edhe për mobilitete/shkëmbime rinore. Për procedurat e aplikimit dhe afatet e kësaj thirrje, mund të kontaktoni direkt me personat përgjegjës, e që në Kosovë pikë kontakti është Organizata Jo Qeveritare rinore “GAIA”.



MUNDËSITË E PROGRAMIT

Erasmus+
PËR SPORT

1. KA2 Projekte për ngritjen e kapaciteteve në fushën e Sportit: janë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian që synojnë përmirësimin e kapaciteteve në fushën e sportit, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës sportive, trajnimin dhe edukimin e profesionistëve të sportit, dhe promovimin e sporteve dhe aktiviteteve fizike. Ato fokusohet në rritjen e mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar dhe shkëmbim përmes aktiviteteve sportive. Programi mbështet aktivitetet sportive ndërkombëtare për individë dhe organizata që promovojnë sportin dhe aktivitetet fizike.

Si të aplikoni: Aplikimi bëhet përmes platformës online ‘FTOP’ (Funding and Tenders opportunity Portal) dhe kërkohet dokumentacion specifik për secilën thirrje.

**Vini re që këto projekte kanë numër të caktuar(minimal) të partnerëve të përfshirë për cdo kategori të projekteve.*

Afatet e aplikimit: Afatet ndryshojnë sipas thirrjes dhe institucioni duhet të respektojë datat për aplikim dhe dokumentet përkatëse.

2. KA2 Partneritetet e bashkëpunimit në fushën e Sportit: janë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian që mbështesin zhvillimin e aktiviteteve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare në sport. Këto projekte fokusohen në përmirësimin e aftësive të profesionistëve të sportit, promovimin e aktiviteteve fizike dhe sporteve, dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet organizatave sportive të ndryshme.

Si të aplikoni: Aplikimi bëhet përmes platformës online ‘FTOP’ (Funding and Tenders opportunity Portal) dhe kërkohet dokumentacion specifik për secilën thirrje.

**Vini re që këto projekte kanë numër të caktuar(minimal) të partnerëve të përfshirë për cdo kategori të projekteve.*

Afatet e aplikimit: Afatet ndryshojnë sipas thirrjes dhe institucioni duhet të respektojë datat për aplikim dhe dokumentet përkatëse.

MUNDËSITË
E
PROGRAMIT

Erasmus+

PËR
INDIVIDËT



Cilat janë thirrjet e hapura për individët (studentë, staf akademik, staf administrativ) në Erasmus+?

KA1 “SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFIN DHE STUDENTËT” (INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY)

Nëse universiteti (publik ose privat) ku studioni ose punoni është përzgjedhur për të marrë pjesë në një projekt bilateral në kuadër të *International Credit Mobility*, studentët mund të përfitojnë nga mundësitë e shkëmbimeve afatshkurtra nga 3 deri në 12 muaj për Bachelor, Master dhe PhD, dhe nga 5 ditë deri në 2 muaj për stafin akademik dhe administrativ. Mund të përfitoni nga shkëmbimet me Erasmus+ disa herë si student ose për trajnim, por koha totale e kaluar jashtë (përfshirë periudhat e studimit) nuk duhet të kalojë 12 muaj brenda një cikli studimi.

Kriteret gjuhësore (gjuha dhe niveli i kërkuar) janë të përcaktuara në marrëveshjen ndër-institucionale midis dy universiteteve.

CILËT JANË HAPAT QË DUHET TË NDJEKIN STUDENTËT: Individët duhet të kontaktojnë zyrat e marrëdhënieve me jashtë pranë universitetit ku janë duke vijuar studimet për të mësuar nëse ekziston një projekt shkëmbimesh Erasmus+. Ata duhet të informohen për hapjen e aplikimeve individuale, kriteret e përzgjedhjes, afatet e aplikimit, etj. Një student duhet të dijë që: Kriteret e përzgjedhjes për studentët dhe stafet negocohen midis institucionit dërgues dhe atij pritës. Ato duhen bërë publike me hapjen e aplikimeve dhe të shpërndahen në një shkallë sa më të gjerë. Njohja e periudhës së studimit është kusht i detyruar midis institucionit pritës dhe atij dërgues. Institucioni pritës është i detyruar të pajisë studentin dhe institucionin dërgues me listën e notave. Institucioni dërgues duhet të njohë plotësisht modulet që studenti ka kryer gjatë shkëmbimit dhe t’ia regjistrojë ato në listën e notave. Për këtë arsye, studenti plotëson “Marrëveshjen për kryerjen e studimeve (Learning Agreement for studies) (shih linkun: http://erasmusplus.al/sq/?page_id=1068) Marrëveshja për kryerjen e studimeve plotësohet nga studenti para mobilitetit, bazuar në modulet që ai zgjedh të kryejë në universitetin pritës (tabela A). Këto module janë paraqitur në katalogun e vënë në dispozicion nga universiteti pritës. Gjithashtu studenti plotëson tabelën B me modulet përkuese në universitetin dërgues, të cilat do t’i njihen pas periudhës së shkëmbimit. Marrëveshja nënshkruhet nga studenti, personi përgjegjës në universitetin dërgues dhe personi përgjegjës në universitetin pritës.

BURSAT TË PLOTA MASTER PËRMES 'ERASMUS MUNDUS MASTER I PËRBASHKËT'

Çfarë është EMJM?

Erasmus Mundus Joint Master (EMJM) është një program i përbashkët ndërkombëtar studimi në nivel Master, i ofruar nga konsorciume universitare nga vende të ndryshme.

Kohëzgjatja

Programi zgjat **12–24 muaj** (60, 90 ose 120 ECTS) dhe kërkon studime në **të paktën dy vende programi**.

Përfitimet

- **Diplomë e përbashkët ose e shumëfishtë** nga universitetet partnere.
- **Bursa e plotë** që mbulon tarifat e shkollimit, sigurimin, shpenzimet e udhëtimit dhe një pagesë mujore jetese.
- Bursa është më e lartë për studentët jo-BE (deri në 75% më shumë).

Si të aplikoni?

- Shumica e thirrjeve hapen nga **tetori deri në janar** të çdo viti (Secili program i ka afatet e ndryshme të aplikimit).
- Dokumentet kryesore: **letër motivimi, diplomë dhe lista notash, certifikatë gjuhe (TOEFL/IELTS), dy letra reference, etc.** (Secili program i ka kriteret e veçanta të aplikimit).

Për detaje dhe aplikim online: [EMJM Catalogue](#)

KONTAKTI DHE INFORMACIONI

SI TË APLIKONI PËR ERASMUS+?

Aplikimi bëhet online përmes platformës Erasmus+. Për çdo thirrje gjeni detajet dhe dokumentet e nevojshme në udhëzuesit përkatës.

Platforma e aplikimeve: FTOP

Hapi fillestar për aplikim: Hapja e numrit PIC (Personal Identification Code), e cila bëhet në platformën FTOP.

PYETJE TË SHPESHTA

- Për ndihmë, kontaktoni zyrën Erasmus+ në Kosovë.
- Disa thirrje bëhen përmes Agjencive të vendeve të Programit, të tjerat direkt në platformën e Komisionit Evropian.

BURIME

Vizitoni faqet dhe platformat zyrtare të Erasmus+ për informacion të përditësuar mbi thirrjet dhe mundësitë. Rregullat dhe afatet e aplikimit mund të ndryshojnë nga viti në vit, andaj Udhëzuesi i Programit është dokumenti i vetëm zyrtar për çdo thirrje të Programit Erasmus+.

NA KONTAKTONI



+383 (38) 244 884



www.erasmuspluskosovo.org



[Kosovo Erasmus+ Office](#)



[erasmuspluskosovo](#)



office@erasmuspluskosovo.org



Street Rexhep Mala, ICK building,
3rd floor, | 10000, Prishtine